

UDHËZIM
Nr. 11, datë 2.7.2014

PËR VENDNDODHJEN DHE KUSHTET E TJERA TË TREGJEVE TË SHITJES ME SHUMICË

Në mbështetje të nenit 102, pika 4, të Kushtetutës, me propozim të Drejtorisë së Prodhimit Bujqësor dhe Politikave Tregtare, Ministri i Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave

UDHËZON:

1. Tregjet e produkteve agro-ushqimore me shumicë duhet të plotësojnë këto kritere:

- a) Të jenë jashtë vijës së verdhë të qyteteve në një distancë jo më të afërt se 500 m nga vija e verdhë;
- b) Me një distancë jo më pak se 500 m nga zona të miratuara për banim ose pushim;
- c) Brenda zonave të miratuara për ushtrimin e aktivitetit të tregtimit të produkteve agro-ushqimore me shumicë, të përcaktuara në këtë udhëzim;
- d) Pranë rrugëve kryesore dhe lehtësisht i aksesueshëm;
- e) Jo më pak se 1 kilometër larg zonave të kontaminuara ose me ndotje mjedisore, si fabrika që prodhojnë ose gjenerojnë mbetje të dëmshme për shëndetin, mbetje kimike etj.;
- f) Duhet të kenë 2 porta, një hyrëse dhe një dalje;
- g) Numri i magazinave brenda stabilimentit të jetë jo më pak se 10 (dhjetë);
- h) Të ketë ambiente frigoriferike;
- i) Të ketë ambiente të veçanta për punonjësit;
- j) Objekti të jetë i rrethuar; të jetë i pajisur 24 orë me ujë dhe energji elektrike.

2. Për zbatimin e këtij udhëzimi ngarkohet Drejtoria e Prodhimit Bujqësor dhe Politikave Tregtare dhe Autoriteti Kombëtar i Ushqimit.

Ky udhëzim hyn në fuqi menjëherë.

MINISTRI I BUJQËSISË, ZHVILLIMIT RURAL DHE ADMINISTRIMIT
TË UJËRAVE
Edmond Panariti